



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Ministarstvo Rada i Socijalne Zaštite
Ministry of Labour and Social Welfare*

UDHËZUESI NUMËR 19

**SANDARDET MINIMALE TË CILËSISË SË SHËRBIMEVE SOCIALE
NË-SHTËPI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

STANDARDET MINIMALE TË CILËSISË PËR SHËRBIME SOCIALE NË-SHTËPI PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA

QËLLIMI I SHËRBIMEVE SOCIALE NË SHTËPI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Qëllimi i shërbimeve sociale në –shtëpi për personat me aftësi të kufizuara është ruajtja dhe përmirësimi i cilësisë së jetës në mjedisin e tyre natyral, duke ofruar kujdes dhe ndihmë profesionale.

GRUPET E PRIORITETIT

Grupet e prioritetit për shërbime sociale në-shtëpi për persona me aftësi të kufizuara janë:

- Fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Të rriturit e vetëm me aftësi të kufizuara;
- Të rriturit me aftësi të kufizuara që jetojnë në familje

PARIMET KRYESORE

- Respekti dhe ndjeshmëria ndaj personalitetin dhe nevojat personale të personave me aftësi të kufizuara;
- Ndërtimi i marrëdhënieve të ndërsjella besimi;
- Ofrimi i ndihmës dhe shërbimeve, duke marrë parasysh kapacitetet fizike dhe intelektuale të personave me aftësi të kufizuara;
- Integrimi promovues i personave me aftësi të kufizuara në jetën shoqërore;
- Përjashtimi i çfarëdo lloji të abuzimit (verbal, psikologjik, fizik, seksual etj.)

AKTIVITETET KRYESORE PËR SHËRBIME SOCIALE NË-SHTËPI PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Aktivitetet vijuese do të kryhen përmes shërbimeve në-shtëpi:

- Ofrimi i kujdesit personal – higjiena, infermiera elementare mjekësore, asistenca fizike
- Ofrimi i ndihmës në familje – pastrimi, gatimi, blerja, pagesa e faturave
- Asistenca në jetën sociale – leximi, komunikimi, nxjerrja jashtë për shëtitje, asistenca në qasje në shërbimet sociale të disponueshme;
- Asistenca në arsimim –

STANDARDET MINIMALE

Standardet Minimale Strukturale	Indikatorët e Performancës
X.1.1 Ofrimi i shërbimit në –shtëpi do të menaxhohet dhe bashkërendohet.	<ul style="list-style-type: none">• Një menaxher dhe së paku një koordinator në rast kur shërbimet janë ofruar nga organizata e specializuar;

	<ul style="list-style-type: none"> Një koordinator në rastin kur shërbimet në-shtëpi ofrohen nga organizatat që ofrojnë shërbime të ndryshme (p.sh QPS-të, OJQ-të) qendrat e kujdesit ditor, etj)
X.1.2 Shërbimet sociale në – shtëpi do të ofrohen nga Punëtori/ja i/e kujdesit social të licencuar	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e licencave të ofruara për punëtor social me arsim elementar; Dëshmi e dokumentuar e njohurisë së infermierisë elementare mjekësore
X.1.3 Një punëtor/e i/e kujdesit social të licencuar do të ofroj shërbime në-shtëpi për jo më shumë se 6 përfitues	Numri i përfituesve /Numri i punëtorëve të licencuar të kujdesit social
Standardet funksionale	Indikatorët e performancës
X.2.1 Organizata i për ofrimin e shërbimit social në-shtëpi do të përgatisë përshkrimin e të gjitha shërbimeve në dispozicion. Në përshkrim do të ketë qasje publiku i përgjithshëm.	<ul style="list-style-type: none"> Broshurat, fletëpalosjet Ekzistenca e rregulloreve të brendshme
X.2.2 Organizata për ofrimin e shërbimit social në-shtëpi do të siguroj që informatat adekuate lidhur me shërbimet në dispozicion dhe personeli i prezantohet anëtarëve të familjes, të afërme të përfituesve dhe palëve të tjera të interesit.	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e rregulloreve të brendshme
X.2.3 Organizata për ofrimin e shërbimit social në-shtëpi do të ketë procedura për të mbikëqyrur cilësinë e ofrimit të shërbimit.	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e rregulloreve për të intervistuar përfituesit dhe të afërmit e tyre
X.2.4 Menaxheri/koordinatori i shërbimeve në-shtëpi do të jetë përgjegjës për regjistrimin e përfituesve të shërbimeve në-shtëpi.	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e bazës së të dhënave
X.2.5 Menaxheri/koordinatori i shërbimeve në-shtëpi do të jetë përgjegjës për përpilimin dhe ndjekjen e orarit të shërbimeve të punëtorëve të kujdesit social	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e rregulloreve të brendshme
X.2.6 Organizata për ofrimin e shërbimit social në-shtëpi do të ketë rregullore për të zëvendësuar punëtorët e kujdesit social kur ata nuk janë në gjendje për të kryer vizita të planifikuara (sëmundje, emergjencë, kërkesë të arsyeshme nga përfituesi, etj)	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e rregulloreve të brendshme
X.2.7 Organizata për ofrimin e shërbimit social në-shtëpi do të ketë procedura për të pranuar dhe adresuar ankesa nga përfituesit dhe anëtarët e familjes së tyre.	<ul style="list-style-type: none"> Ekzistenca e procedurave të ankimit ; Numri dhe natyra e ankesave
X.2.8 Punëtori/ja i/e kujdesit social do t'i sqaroj përfituesit qëllimin e shërbimeve. Aktivitetet precize dhe shërbimet, si dhe orari i	<ul style="list-style-type: none"> Dëshmi e nënshkruar nga përfituesi dhe ofruesi i shërbimit mbi llojin e

vizitave do të bëhet në pajtueshmëri me përfituesin dhe anëtarët e familjes së tij/saj.	shërbimit dhe orarin e ofrimit të shërbimeve.
X.2.9 Punëtori/ja i/e kujdesit social do të siguroj higjienën personale të përfituesit duke ofruar ndihmë të nevojshme bazuar në nevoja (p.sh larja, pastrimi, pastrimi në shtrat, ndërrimi i mbulesave të shtratit, etj)	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.10 Kur është e nevojshme punëtori/ja i/e kujdesit social do të ndihmoj përfituesin për t'u ushqyer, përfshirë ushqyerjen në shtrat.	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.11 Punëtori/ja i/e kujdesit social do të ofroj asistencë elementare të kujdesit shëndetësor për përfituesin bazuar në nevoja (p.sh matja e tensionit të gjakut, pas përshkrimit të mjekut në marrjen e medikamenteve në kohë, asistencë në ushtrimet fizike, etj).	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.12 Kur është e nevojshme, punëtori/ja i/e kujdesit social do të shoqëroj përfituesin në rehabilitim dhe/ose shërbime të kujdesit shëndetësor.	<ul style="list-style-type: none"> • Ekzistenca e procedurave të ankimit; • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.13 Punëtori/ja i/e kujdesit social do të ndihmoj në familje të përfituesit, bazuar në nevoja. Kjo mund të përfshij: <ul style="list-style-type: none"> • Pastrimin e shtëpisë ose dhomës së përfituesit; • Laj rrobat e tij/saj; • gatimin (duke përfshirë ushqimin special dietal); • blerjen; • pagesën e faturave të rrymës, ujit, etj 	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.14 Punëtori/ja i/e kujdesit social do të ndihmoj në jetën shoqërore të përfituesit, bazuar në llojin e aftësisë së kufizuar, nevojat dhe kapacitetet e përfituesit. Kjo mund të përfshij: <ul style="list-style-type: none"> • leximin dhe diskutimin e gazetave dhe librave; • identifikimin e temave dhe subjekteve të interesit dhe duke pasur biseda që do t'i interesonin përfituesit; • ndihmën në mbajtjen e kontakteve me të afërmit dhe/ose miqve; • nxjerrjen jashtë për shëtitje (nëse është e mundshme); • paraqitjen e shërbimeve sociale dhe mbështetjen në përdorimin e këtyre shërbimeve 	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar
X.2.15 Kur kërkohet punëtori/ja i/e kujdesit social do të ofroj ndihmë në procesin e arsimit të përfituesit. Kjo mund të përfshij: <ul style="list-style-type: none"> • Ndihmën në punët e shtëpisë; • Shoqërimin në institucione arsimore. 	<ul style="list-style-type: none"> • Dëshmi e dokumentuar e ndihmës së ofruar